

VENDIM
Nr. 266, datë 6.9.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SHPK PËR MARRJEN E MIRATIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) TË ASETEVE TË PALUAJTSHME SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a” dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 2, germa “a”, 34, gjerat “a” dhe “b”, 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2048/1 prot., datë 4.9.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Dragobia Energy’ sh.p.k. për marrjen e miratimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Cerem” dhe “Dragobi”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 6.2.2016 dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 16.4.2021.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2048 prot., datë 21.8.2023, i licencuari “Dragobia Energy” sh.p.k. dhe koncesionari “Gener 2” sh.p.k., kanë paraqitur kërkesën për marrjen e miratimit nga ERE për transferimin e aseteve të luajtshme e të paluajtshme (nëpërmjet barrësimit/hipotekimit) të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., Bankës së Tiranës sh.a. dhe Union Bank sh.a.

- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe neneve 2, germa “a”, 3, 5 germa “j” dhe 6 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, ERE merr në shqyrtim kërkesat e të licencuarve për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar. Në këto rrethana, kërkesa e shoqërisë për transferimin e aseteve të luajtshme nuk mund të merret në shqyrtim.

- Kërkesa për transferimin e aseteve është nënshkruar nga shoqëria e licencuar nga ERE “Dragobia Energy” sh.p.k. dhe koncesionari/ortaku i vetëm i saj “Gener 2” sh.p.k., duke plotësuar përcaktimin e nenit 4, germa “a” të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, palë në këtë proces, që gëzon të drejtën për të paraqitur një kërkesë për transferimin e aseteve është i licencuari, ndaj në shqyrtimin e këtij aplikimi do t’i referohemi të licencuarit nga ERE në veprimtarinë e energjisë, shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k.

- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, rezulton se shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “e”, “f”, “g” dhe “j”; pikën 4 dhe pikën 6.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 7

Pika 1

- germa “c”: Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE nëpërmjet pasqyrave financiare apo çdo dokumenti tjetër, shpenzimet e kryera nga “Gener 2” sh.p.k. në kuadër të financimit për ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve “Dragobia” dhe “Cerem”.

- germa “d”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim asetë, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare.

- germa “h”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen paraprake të nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen.

- germa “i”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE një deklaratë me shkrim të personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit.

- germa “j”: Shoqëria duhet të bëjë me dije në rast se ka pasur transferime të këtyre aseteve të kryera më herët dhe nëse ka pasur të depozitojë listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt.

- Pika 3. Shoqëria duhet të shprehi në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohet për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë tek përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Autoritetit Shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. për transferimin e aseteve të luajtshme të saj.

2. Të fillojë procedurën për dhënien e miratimit për transferimin e aseteve të paluajtshme (nëpërmjet hipotekimit) të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., Bankës së Tiranës sh.a. dhe Union Bank sh.a.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k., shoqërinë “Gener 2” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti